



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVA

C-II-18-0041

Paditësi/ Ankuesi

C0001 N.C., Berane

Kundër / të paditurit :

NSH "KLK" Pejë, të cilën e administrojnë **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Agim Ramadani", Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Teuta Ibrahim, më 17 shtator 2019, lëshon këtë:

AKTVENDIM

I. Hudhet si e PA PRANUESHME ankesa e ankuesit:

C0001- N.C.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Ankuesi është ish punëtorë të ndërmarrjes shoqërore – **"KLK" Pejë**, e cila ishte privatizuar më 6 shkurt 2006.

Lista Përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime ishte publikuar më datat 22,23, dhe 24 dhjetor 2011 në gazetën ditore në gjuhën shqipe "Infopress" dhe "Zëri" dhe në gazetën ditore në gjuhën serbe me datat 22,23,24 dhe 25 qershor 2011 në gazetën "Danas" si dhe me datat 29,30 dhe 31 dhjetor 2011 dhe më 1 e 2 janar në gazetën "Vjesti". Data e fundit për dorëzimin e ankesave në AKP kundër Listës Përfundimtare ishte 14 janar 2012. Me njoftimin e datës 29 dhjetor 2011 të bërë nga AKP-ja në gazetën ditore të lartcekura afati i fundit për paraqitjen e ankesave është zgjat nga data 14 janar 2012 deri më 21 janar 2012.

Aktivendimi është nxjerr, pa mbajtur shqyrtimin publik, për shkak se faktet dhe argumentet juridike të cilat janë ofruar janë mjaftueshëm të qarta. Dhoma e Posaçme nuk pret informata të tjera relevante për shqyrtim. Neni 72 paragrafi 11 i Ligjit për Dhomen e Posaçme nr. 06/L-086).

C0001:

Më 28 mars 2018, ankuesi N.C., parashtrori ankesën e vet pranë DHPGJS për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit kundër listës së përfundimtare të NSH "KLK" Pejë. Në ankesën e tij ai kërkon përfshirjen në listën përfundimtare të punëtorëve, për të marrë pjesën e të ardhurave nga privatizimi i NSH-së gjegjësisht 20 %. Ankuesi ka pohuar se, ka marrë përgjigje negative nga AKP-ja dhe ata e kanë udhëzuar të drejtohet DHPGJS me arsyetimin se nuk ka parashtruar ankesë në afatin e paraparë i cili ka kaluar në janar 2012. Ankuesi po ashtu ka pohuar se, është person i hendikepuar (i shurdhër) dhe si i shpërngulur jeton në Berane nga viti 1999 dhe nuk ka pas mundësi komunikimi me persona tjerë për të ditur afatin e paraparë.

Në mbështetje të pretendimeve të tij parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë:

Më 21 qershor 2018, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka dorëzuar përgjigje në Dhomën e Posaçme përmes së cilës propozon që ankesa e ankueses të hedhet poshtë si e papranueshme ngase ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë.

Më 04 korrik 2018 ankuesi e ka pranuar përgjigjen e AKP-së por nuk ka parashtruar ndonjë kundërpërgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe provat e deponuara në lëndë janë mjaft të qarta, andaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 të Ligjit të DHPGJSK (Nr. 06 L-086).

Shqyrtim i përgjithshëm:

Neni 10.1 i Rregullores 2003/13 i rregullon të drejtat e të punësuarve dhe procedurën për përfutimit të 20 % -it nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore.

Neni 10.2 i Rregullores së lartcekur përcakton se si organi përfaqësues i NSH-së në bashkëpunim me Sindikatën e Pavarur përpilon Listën Preliminare dhe të njëjtën ia dërgon Agjencisë që ta shqyrton listën dhe të bëjë ndryshimet e nevojshme për të siguruar qasje për të gjithë të punësuarit.

Neni 10.3 i Rregullores së lartcekur përcakton se lista zyrtare – përfundimtare e të punësuarve me të drejta legjitime lëshohet nga agjencia me njoftimi për të drejtën në ankesë në pajtim me Nenin 10.6 dhe publikohet në gazetën kryesore në gjuhën shqipe dhe serbe .

Neni 10.4 i Rregullores së lartcekur përcakton se punëtori konsiderohet legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në Listën e Pagave të NSH-së për jo më pakë se tre (3) vite, kjo e drejtë nuk i ndalon edhe punëtorët të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin në regjistrë si punëtor po mos të ishin të diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.

Neni 10.6 i Rregullores së lartcekur përcakton se pas paraqitjes së kërkesës nga individit me të drejtë të cenuar ankesa lidhur me listën e punëtorëve me të drejtë legjitime i dërgohet Dhomës së Posaçme për shqyrtim.

Neni 10.6 pika (a) tregon kohën që brenda njëzet (20) ditësh pas shpalljes përfundimtare të listës në media sipas Nenit 10.3.

Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda njëzet (20) ditësh pas shpalljes së Listës përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime, e lëshuar nga Agjencia, së bashku me njoftim për të drejtën në ankesë, të publikuar në dy (2) ditë pune të njëpasnjëshme dhe në fundjavë vijuese, në gazetatat kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjerë në Kosovë dhe në gazetatat në Serbi dhe Mal të Zi (shih dispozitën e Nenit 10.6 pika (a) të Rregullores 2003/13).

Neni 130.3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 gjithashtu përcakton se: *'pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme'*.

Vlerësimi i ankesës së ankuesit të cituar si në dispozitiv të këtij Aktvendimi :

Parashtruesi i ankesës N.C., ankesën kundër listës përfundimtare e ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme më 17 maj 2018, që do të thotë jashtë afatit të paraparë kohor, dhe në kundërshtim me dispozitën e Nenit 10.6 (a) të Rregullores së lartcekur. Afati i fundit për paraqitjen e ankesës në Dhomën e Posaçme ka qenë 14 janar 2012 deri më 21 janar 2012. d.m.th. 6 (gjashtë) vite pas skadimit të afatit kohor. Gjykata nuk gjen se, paditësi ka paraqitur prova lidhur me mos paraqitjen e padisë në afatin e paraparë. Andaj, padia do të konsiderohet përfundimisht si e paafatshme dhe e papranueshme, pa asnjë mundësi për të marrë në konsideratë ndonjë arsyetim pa marrë parasysh justifikimet e paditësit, dhe pa marrë parasysh se sa të rëndësishëm mund të jenë këto justifikime. Rrjedhimisht, ashtu siç u cek më lartë se – nuk mund të kërkohet asnjë kthim në gjendje të mëparshme nga paditësi dhe as të miratohet nga Gjykata pasi të kenë kaluar dy muaj nga data e mosveprimit.

Meqë i njëjti nuk iu ka përmbajtur dispozitës së lartcekur (çka do të thotë e ka lëshuar afatin për ankesë), Gjykata nuk u lëshua në merita të lëndës andaj ankesa hidhet poshtë si e pa pranueshme.

Kësisoj ankesa nuk është parashtruar në përputhje me nenin 72 paragrafi 7 të Ligjit të DHPGJSK (Nr. 06 L-086) i cili parasheh që: *'Pala e pakënaqur me listën përfundimtare, pavarësisht nëse është ankuar ndaj listës preliminare apo jo, ka të drejtë të dorëzojë ankesën me shkrim pranë Dhomës së Posaçme para skadimit të afatit kohor prej njëzet (20) ditësh...'*

Për arsyet e lartcekura gjykata nuk është lëshuar fare në merita lidhur me këtë çështje.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Teuta Ibrahim – Gjyqtare _____